


AKSESI NË SISTEMIN E DREJTËSISË DHE TË DREJTËN E INFORMIMIT NGA MINORITETI ROM DHE GRUPE TË MARGJINALIZUARA NË LUSHNJE DHE POGRADEC.



Përgatiti: Rromano Kham
Kontakt: rromanokham@gmail.com
Publikuar: Korrik 2019
Numri i karaktereve: 3000 fjalë.

Tematika e studimit:

Aksesit në sistemin e drejtësisë dhe fuqizimi ligjor i grupeve të marginalizuara, veçanërisht minoritetet romë dhe egjiptiane, mbetet ndër problematikat që kanë njohur më pak zhvillim dhe marrin më pak vëmendje për shkak të natyrës që paraqet fusha e drejtësisë, dhe kohëzgjatjes që do të duhej për të fuqizuar dhe edukuar popullatën me frymën e ligjit dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Pengesat që e bëjnë të vështirë aksesin në drejtësi për romët dhe egjiptianët lidhen në rradhë të parë me mungesën e informacionit, nivelin e arsimimit, dhe të ardhurat ekonomike. Këto tre faktorë janë përcaktuesit kryesorë sipas studimit të UNDP – Suvery on Access to Justice, 2017 (Milatovic, 2017, p. 18).

Sipas po këtij studimit, nga 1758 pyetësorë të administruar, përfshirë intervista, dhe fokus grupe rezulton se gjysma e popullatës të studiuar ka pasur probleme ligjore pesë vitet e fundit, të cilët nuk kanë gjetur mbështetje si pasojë e mungesës së ndërjegjësimit lidhur me sistemin e drejtësisë dhe ligjet në vecanti, si edhe performancës së dobët nga institucionet e drejtësisë. Situata vazhdon e rëndohet tek grupet e disavantazuara si të varfërit dhe romët (Milatovic, 2017, p. 7).

Qëllimi i organizatës Rromano Kham në këtë projekt është, Edukimi dhe Fuqizimi i Komunitetit Rom përmes të Drejtës së Informimit për të Aksesuar Sistemin e Drejtësisë në Lushnje dhe Pogradec. Pjesë e rëndësishme e këtij projekti është studimi në terren përmes së cilës synon të trajtojë 4 çështje të cilat duhen marrë në shqyrtim nga Bashkitë Lushnje dhe Pogradec, Ministria e Drejtësisë, dhe institucionet me të cilat Rromano Kham bashkëpunon të tilla si, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe Klinika e Ligjit e cila financohet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe është nën varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

- Njohuritë mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe konceptet e aksesit në drejtësi.
- Niveli i njohjes së institucioneve të pavarura të cilët ofrojnë mjete ligjore pa pagesë si dhe harta e problematikave me të cilat përballen minoriteti rom dhe egjiptian në Lushnje dhe Pogradec.
- Njohja e ligjit për të drejtën e informimit, programit të transparencës pranë pushtetit lokal.
- Vështirësitë dhe pengesat për të aksesuar sistemin e drejtësisë dhe çfarë do ta përmirësonte aksesin në drejtësi.

Metodologjia e studimit.

Studimi përfshin një kombinim të metodave sasiore dhe cilësore për të komplementuar analizën dhe rezultatet e studimit.

Janë zhvilluar gjithësej 140 pyetësorë, nga të cilat 70 në Lushnje, në zonat Savër dhe Plug, dhe 70 të tjera në Pogradec, në zonat, “ish-repartit ushtarak” dhe “guri i kuq”. Si edhe dy fokus grupe me 19 pjesmarrës.


Nga 140 pyetësorë, (40%) e të intervistuarve ishin femra, ndërsa (60%) meshkuj.

Nga 140 pyetësorë, (85.71%) e të intervistuarve kanë kryer 1 ose të gjitha klasat e arsimit të detyrueshëm. Ndërsa, (14.29%) kanë kryer të paktën 1 vit të arsimit të mesëm ose kanë përfunduar arsimin profesional.

Më poshtë janë të paraqitura të dhënat të agreguara sipas nivelit arsimor për Lushnjen dhe Pogradecin.


NIVELI ARSIMOR I TE INTERVISTUARVE ROM DHE EGJIPTIAN NE SAVRA DHE PLUG NE LUSHNJE

■ Klase (1-4) ■ Klase (5-8) ■ Klase (9-13) ■ Refuzon (88)



NIVELI ARSIMOR I TE INTERVISTUARVE NE POGRADEC

■ Klase 0-4 ■ Klase 5-8 ■ Klase 9-12



Pjesëmarrësit në fokus grup vinin nga moshë, dhe profesione të ndryshme. Niveli arsimor dhe problematikat ishin të përbashkëta. Pjesëmarrësit nga Pogradeci ishin të gjithë meshkuj¹ në fokus grup, të cilët ngritën shqetësimet si më poshtë:

1. Mungesën e aksesit në strehim;
2. Kushtet e papërshtatshme të strehimit;
3. Pasigurinë për banesën dhe frika nga dëbimet e dhunshme.

Pjesëmarrësit nga Lushnja, meshkuj dhe femra të moshave dhe profileve të ndryshme ngritën një panoramë më të gjerë problematikash duke i listuar si më poshtë:

1. Mungesa e informacionit rreth statusit të banesave në proces legalizimi në Savër dhe Plug;
2. Mungesa e informacionit për të aksesuar programet e strehimit;
3. Pamundësia për të ndjekur procedurialisht dhe financiarisht raste divorci dhe birësimi;
4. Mungesa e cilësisë në infrastrukturë;
5. Aksesit në tregun e punës;
6. Aksesit në përfitim të programeve të mbrojtjes sociale;

Qëllimi i projektit dhe objektivat.

Qëllimi i projektit: Edukimi dhe Fuqizimi i Komunitetit Rom përmes të Drejtës së Informimit për të Aksesuar Sistemin e Drejtësisë është zbatuar në qytetin e Lushnjes, në zonat Savër dhe Plug, dhe në qytetin e Pogradecit. Qëllimi i projektit ishte edukimi, ndërgjegjësimi dhe ndarja e informacionit me pjestarët e komunitetit Rom dhe jo-Rom në mënyrë sa më praktike rreth të drejtave të njeriut, dhe mjetet ligjore falas të ofruara nga institucionet të pavarura që kanë në thelb të veprimtarisë së tyre garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe mbrojtjen e tyre.

Objektivat kryesore të implementimit të projektit janë:

- Edukimi praktik i pjestarëve të komunitetit në zonat e targetuara për të aksesuar sistemin e drejtësisë përmes të drejtës së informimit.
- Informacione dhe mësim të thjeshta rreth të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të drejtës për informim.
- Marrja e informacionit publik dhe në interes të individit ose kolektivit. E segmentuar në aktivitete, përgatitja e kërkesave ose ankesave Avokatit të Popullit; përgatitja e ankesave për shqyrtim Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; kërkesa për informacion Bashkisë në zonën përkatëse apo institucioneve të caktuara për të ngritur problematika komunitare.

Përkufizime dhe njohuri mbi institucionet që ofrojnë mjete ligjore falas.

E drejta e informimit: E drejtë themelore e individit, e shprehur qartë në ligjin për të drejtën e informimit si dhe në akte të tjera ndërkombëtare². Cdo individ ka të drejtë të shprehet, të informohet, të japë dhe të marrë informacion sipas ligjit, pa cënuar të drejtat e personave të tjerë. E drejta e informimit ka kufizime të përcaktuara qartë në ligj, me qëllim për të mbrojtur të drejtat e personave të tjerë.

¹ Mungesa e grave romë dhe egjiptiane vjen si pasojë e mentalitetit në komunitet dhe dallimeve të dukshme gjinore. Gjatë aktiviteteve pjesëmarrja e femrave ka qenë shumë e ulët dhe në shumicën e rasteve kanë qenë të reja dhe të arsimuara.

² Ligj Nr.119/2014, Për të Drejtën e Informimit

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi³: Ka si qëllim të zbatojë parimin e barazisë në mënyrë që njerëzit të mos diskriminohen për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, etnisë, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqerore, moshës, gjendjes shëndetësore dhe dallimeve të tjera.

Diskriminim: Do të kuptojmë, kur një person apo grup personash trajtohet në mënyrë të pabarabartë për shkaqet e përmendura më sipër. **Diskriminim mund të jetë i hapur ose i fshehur.**

Avokati i Popullit: Institucion kushtetues dhe i pavarur i cili mbron të drejtat dhe interesat e qytetarëve nga veprimet e paligjshme, ose të parregullta të administratës shtetërore.

Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale: Institucioni i cili ndër të tjera trajton ankesa në rast se ndonjë institucion nuk e ofron në kohë apo në mënyrë të plotë informacionin e kërkuar.

Harta e problematikave ligjore të minoritetit Rom dhe grupeve të marginalizuara në Lushnje dhe Pogradec.

Në qytetin e Pogradecit, shqetësimi kryesor që ngrihet nga pyetësorët, fokus grupet, dhe diskutimet gjatë aktiviteteve me Rromano Kham, është mungesa e aksesit në strehim.

Rreth 40 banorë nga zona e ish-repartit Ushtarak jetojnë prej vitesh në një repart ushtarak, mungesa e informacionit rreth programeve të strehimit nga njëra anë, dhe mungesa e njohurive rreth instrumentave ligjore falas nga ana tjetër, ka penguar prej vitesh banorët e kësaj zone që të reagojnë për të përmirësuar situatën e tyre në strehim.

Një zonë problematike përsa i përket kushteve të jetesës dhe cilësisë së strehimit paraqitet zona që njihet si Guri i Kuq. Në këtë zonë jetojnë rreth 20 familje, së fundmi i kanoset rreziku i zhvendosjeve për shkak të projekteve private që po ndodhin.

Në Lushnje, situata e strehimit paraqitet më e qëndrueshme, i vetmi shqetësim për banorët është mungesa e informacionit rreth procesit të legalizimit të banesave të tyre private. Harta e problematikave sidoqoftë paraqitet më e larmishme. Përmes metodave cilësore dhe sasiore si pyetësorët, fokus grupet, mbledhja e të dhënave gjatë aktiviteteve, minoriteti Rom rezulton se në Lushnje ka mungesë të theksuar të aksesit në drejtësi për shkak të mungesës së njohurive në ligj, të drejtën e informimit dhe lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, dhe infrastrukturës për ta bërë të aksesueshme sistemin e drejtësi.

Niveli i njohurive rreth të drejtave the lirive themelore të njeriut.

Të njohësh ligjin dhe konceptet bazike të sistemit të drejtësisë janë elemente të rëndësishme për të aksesuar sistemin e drejtësisë. Minoriteti Rom mund të kategorizohet si grupi më analfabet sa i përket nivelit të informacionit dhe njohurive në të drejtën e informimit dhe mjeteve ligjore falas. Megjithatë përbën parakusht njohja e koncepteve bazike për të aksesuar sistemin e drejtësisë.

Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët në Lushnje dhe Pogradec, dëshmojnë një nivel të ulët të njohurive rreth të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të drejtën për informim, ligjit për ndihmën ligjore falas, dhe njohurive rreth institucioneve të cilat ofrojnë mjete ligjore pa pagesë.

Nga 70 intervista në Lushnje, 32 u përgjigjen se kishin njohuri rreth të drejtave edhe lirive themelore të njeriut, ndërsa 38 të tjerë nuk kishin ansjë informacion. Nëse do të listonin të drejtën me frekuencën më të lartë të përmendur nga të intervistuarit, do të kishim renditjen si në tabelën më poshtë:

³ Ligj Nr. 10 221, datë 4.2.2010, Për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut**Frekuenca: Sa shpesh është përdorur një e drejta gjatë 32 pyetësorëve.**

E drejta për punësim	32
E drejta për informacion	32
E drejta për arsim	22
Liria e shprehjes dhe mendimit	22
E drejta për t'u mbrojtur nga ligji	16
Mosdiskriminimi dhe barazia përpara ligjit	13
E drejta e votës	5
Të drejtat ekonomike, sociale, dhe kulturore	2
E drejta për privatësi	1


Të dhënat në Pogradec na rezultojnë edhe më të thella. Të pyetur se sa njohuri kanë rreth të drejtave dhe liritë themelore të njeriut, të gjithë të intervistuarit janë përgjigjur se nuk kanë informacion, ose njohuri. Duke u bazuar tek fokus grupet që kemi organizuar në Pogradec me pjesëmarrësit, janë shprehur se kanë mungesë njohurish rreth të drejtave të njeriut dhe ligjeve që i vijnë në ndihmë për të aksesuar sistemin e drejtësisë. Mungesa e informacionit rreth mjeteve ligjore, procedurat administrative dhe mungesa e orientimit, ka dekurajuar shumë prej banorëve të cilët kanë probleme me çështjen e strehimit.

Rrjedhimisht, pyetjes nëse mund të listojnë ndonjë të drejtë që i takon dhe mund ta ushtrojnë lirisht, nuk kanë listuar asnjë duke u përgjigjur se nuk kanë njohuri. (shenim i hulumtuesit: Përfituesit e projektit nga qyteti i Pogradecit, kanë njohuri minimale rreth të drejtave dhe liritë themelore të njeriut, por nuk janë të ndërgjegjshëm, ose nuk janë të stërvitur për të kuptuar qoftë edhe teorikisht këto të drejta. Prandaj, janë të nevojshme aktivitetet ndërgjegjëse dhe informuese në mënyrë sa më praktike për t'i fuqizuar me konceptet rreth ligjit dhe të drejtave të njeriut)

Pyetjes, Cilat janë problemet me natyrë ligjore që ju shqetësojnë, me të cilat ju është dashur të përballeni konkretisht. 61 nga 70 të intervistuarit janë shprehur se nuk kanë ndjekur probleme me natyrë ligjore, se nuk kanë informacion se si t'i ndjekin problematikat që i shqetësojnë. Ndërsa vetëm 9 prej tyre kanë shprehur se kanë hasur vështirësi me dokumentat e pronësisë mbi banesën, përfitimin e ndihmës ekonomike, kartën e shëndetit, regjistrimin civil, dhe aksesin në sistemin gjyqësor. Për zgjidhjen e tyre janë shprehur se kanë pajtuar një avokat privat, janë ende në proces informimi se si duhet vepruar për zgjidhjen e problemit, dhe e kanë adresuar çështjen tek institucioni përkatës.


Në Lushnje, lidhur me pyetjen nëse kishin dëgjuar ndonjëherë për ligjin për të drejtën e informimit, 21 nga të intervistuarit u përgjigjën po, ndërsa 43 u shprehën se nuk kishin njohuri. 7 të tjerë nuk janë përgjigjur për pyetjen.

Figura 1 informacion rreth te drejtes per informim, intervistat ne Lushnje



Situatë e ngjashme na rezultojnë edhe me intervistat në Pogradec. Rreth 72% ose 43 të intervistuar, u shprehën se nuk kanë informacion rreth të drejtës për informim. Ndërsa 28% e tyre, ose 17 personat e tjerë u shprehën se kishin dëgjuar për të drejtën për informim. Duke marrë parasysh aktivitetet e organizuara dhe kontaktin e drejtëpërdrejtë me komunitetin, na rezultojnë se informacioni për të drejtën e informimit është në nivelin minimal. Komuniteti rom dhe egjiptian nuk ka informacion për ta shfrytëzuar këtë të drejtë dhe për të përdorur mjetet në dispozicion në rast se kërkesat e tyre nuk shqyrtohen në afatet e përcaktuara në ligj.


Fig 2. Informacion rreth të drejtës për informim në intervistat e realizuara në Pogradec.



Lidhur me pyetjen se sa informacion kishin rreth të drejtës së informimit (vlerësim me shkallë nga 1 – 5, ku 1 aspak, 2 pak, 3 deri diku, 4 mirë, 5 shumë mirë).


46/70 intervista janë shprehur se disponojnë “aspak” informacion rreth të drejtës së informimit. Vetëm 2/70 të intervistuarit në Lushnje, u shprehën se e njohin shumë mirë të drejtën për informim.

Fig 3. Niveli i informacionit nga 1 (aspak) deri tek 5 (shumë mirë) për personat e intervistuar në Lushnje.



Nga intervistat në Pogradec, hendeku i nivelit të informacionit lidhur me të drejtën e informimit na rezultojnë më e thellë. 67/70 të intervistuarit e vlerësuan me 1 ose aspak nivelin e informacionit për të drejtën e informimit. Vetëm 3 e vlerësuan me 2, ose pak.

Fig 4. Niveli i njohurive nga 1 (aspak) deri tek 5 (shumë mirë) për personat e intervistuar në Pogradec.



Për sa i përket pyetjes se si e shpjegojnë mungesën e informacionit lidhur me të drejtën për informim, (37) persona u shprehën se nuk e dinin nga burimet kjo mungesë, ndërsa (33) persona të tjerë u shprehën se ishte për shkak të mungesës së informacionit.

Niveli i njohurive rreth institucioneve që garantojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Lidhur me pyetjen se sa mirë i njohin institucionet si, Avokati Popullit; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Koordinatorin për të drejtën e informimit; Zyra e ndihmës ligjore, pranë Ministrisë së Drejtësisë; Klinika ligjore, pranë Ministrisë së Drejtësisë, nga 1 tek 5, ku 1 është aspak, dhe 5 është shumë mirë.




Fig 5. Niveli i njohurive nga 1 (aspak) deri tek 5 (shumë mirë) për personat e intervistuar në Lushnje.

Nga të dhënat e mbledhur në pyetësorët në Lushnje dhe Pogradec, na rezultojnë se romët dhe egjiptianët kanë shumë aspak ose pak informacion rreth këtyre institucioneve. Duke ju referuar grafikëve, na rezultojnë se të intervistuarit njohin më shumë Avokatin e Popullit.

Por, duke ju referuar të dhënave në vazhdim të pyetësorëve, na rezultojnë se thjesht e kanë dëgjuar por shumë pak informacion kanë për veprimtarinë e tij.




Fig 6. Niveli i njohurive nga 1 (aspak) deri tek 5 (shumë mirë) për personat e intervistuar në Pogradec.

Të pyetur nëse i janë drejtuar ndonjëherë institucioneve të lartpërmendura për të adresuar apo zgjidhur ndonjë problem me natyrë ligjore, ose sociale. Vetëm 15 nga 70 persona të intervistuar në Lushnje u shprehën se ishin drejtuar të paktën një prej këtyre institucioneve. Ndërsa pjesa tjetër nuk i ishte drejtuar asnjëherë.

Ndërsa nga pyetësorët në Pogradec na rezultojnë se asnjë nga të intervistuarit nuk i ishte drejtuar ndonjëherë këtyre institucioneve për mbështetje. Kjo e dhënë mund të shpjegojë edhe mungesën e theksuar të informacionit që personat e këtyre komuniteteve kanë kundrejt institucioneve që mund t'i vijnë në ndihmë problemeve me natyrë ligjore që këta individë kanë.

Të pyetur se sa të vështirë e kanë për të aksesuar sistemin e drejtësisë për të adresuar një problem me natyrë ligjore që i prek drejtpërdrejtë. Të gjithë të intervistuarit nga Lushnja dhe Pogradeci, rom dhe jo-rom, janë shprehur me alternativën (a), shumë të vështirë.

Rromano Kham është e interesuar të kuptojë pengesat e mundshme të cilat minojnë shancet e minoritetit Rom për të aksesuar sistemin e drejtësisë.

Pyetjes rreth pengesat e mundshme që ju pengojnë për të aksesuar sistemin e drejtësisë, është përdorur shkalla e matjes nga 1 (aspak pengesë) deri tek 5 (shumë pengesë). Personave të intervistuar i janë listuar disa arsye që mund të përbëjnë pengesë për të aksesuar sistemin e drejtësisë, dhe secila prej arsyeve është vlerësuar me pikë.

Si në Lushnje ashtu edhe në Pogradec, na rezulton se neglizhenca personale nuk përbën pengesë për të aksesuar në sistemin e drejtësisë, ndërsa të gjitha alternativat e tjera janë vlerësuar me 4 dhe 5 pikë (mjaftueshëm pengesë ,dhe shumë pengesë)

Pengesat e mundshme për të aksesuar sistemin e drejtësisë, nga 1 aspak, 2 pak, 3 disi, 4 mjaftueshëm, 5 shumë mire	Lushnje					Pogradec				
	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5
Neglizhenca Personale	65	1	0	0	4	67	0	3	0	0
Mungesa e informacionit për institucionet, procedurat, dokumentat që duhen plotësuar.	1		1	67	2	0	0	0	0	70
Dekurajimi nga sistemi, si pasojë e burokracisë dhe procedurave të gjata	1	1	1	67	0	0	0	0	0	70
mungesën ose pamundësinë për t'u lehtësuar me ndihmë ligjore falas, ose nga vullnetarë apo aktivistë që mund të ndjekin rastin bashkë me ty)	1	1	1	65	3	0	0	0	0	70
Mungesa e besimit se institucionet mund të marrin parasysh problemet tona	0	1	4	64	1	0	0	0	0	70
Pamundësia për të artikuluar problemin dhe adresuar atë siç duhet pranë institucioneve përkatëse	1	1	1	66	1	0	0	0	0	70
Dekurajimi si pasojë e korrupsionit, (punonjësit nuk të mbarojnë punë nëse nuk paguan rryshfet)	1	1	2	65	1	0	0	0	0	70
Pamundësia për të paguar tarifën e shërbimit	1		1	60	8	0	0	0	0	70

Në Pogradec, të pyetur se si e shpjegojnë mungesën e informacionit, 24 persona janë përgjigjur se është mungesë informacioni dhe sensibilizimi rreth të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe institucioneve që ofrojnë mjete ligjore pa pagesë për të adresuar problematikat e tyre. 10 persona janë shprehur se është mungesë e vullnetit politik. Sipas tyre dhe duke u bazuar në diskutimin me fokus grupin e Pogradecit, institucionet përgjegjëse për çështje si strehimi në nivel lokal, nuk po bëjnë mjaftueshëm për t'i ardhur në ndihmë komunitetit.





Fig 6. Arsyet për mungesën e aksesit në drejtësi, në Pogradec.

Ndërsa 36 persona të tjerë, nuk janë përgjigjur pyetjes, pasi nuk kanë pasur informacion ose nuk kanë kuptuar pyetjen.



Të pyetur se çfarë do ta ndryshonte situatën e tyre për të pasur më shumë akses në sistemin e drejtësisë. 39 të intervistuar në Pogradec u shprehën së vullneti politik, pra ndërhyrja e institucioneve shtetërore aktivisht në informimin e komunitetit dhe ofrimin e ndihmës juridike pa pagesë, do ta përmirësonte dukshëm situatën dhe zgjidhjen e problematikave me natyrë ligjore.

Fig 7. Opinonet e të intervistuarve në Pogradec lidhur me çfarë do ta ndryshonte aksesin e tyre në Sistemin e Drejtësisë.

21 persona të tjerë u shprehën se sesionet e informimit dhe ndërgjegjesimit do t'i fuqizonin mjaftueshëm për të aksesuar sistemin e drejtësisë, dhe për të adresuar problematikave me natyrë ligjore.

9 persona të tjerë u shprehën pesimit. Sipas tyre, asgjë nuk do të mund ta përmirësonte aksesin në drejtësi, e cila mund të përkthehet edhe si tërësia e mjeteve apo veprimeve për zgjidhjen e problematikave me natyrë ligjore.

Ndërsa në Lushnje, të intervistuarit në mënyrë të përmblodhur janë pozicionuar në dy opinione kryesore.

29 të intervistuar mendojnë se sesionet e informimit rreth ligjeve dhe akteve nënligjore që prekin drejtpërdrejtë jetën e tyre, do të ndihkonte pozitivisht në fuqizimin ligjor të tyre.

41 të intervistuarit e tjerë, kanë shprehur një nevojë më gjeneraliste. Sipas tyre, aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese rreth të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, do t'i mundësonte qasjen drejt sistemin të drejtësisë.




Fig 8. Opinonet e të intervistuarve në Lushnje lidhur me çfarë do ta ndryshonte aksesin e tyre në Sistemin e Drejtësisë.

Rekomandime.

1. Fuqizimin ligjor të komunitetit, vecanërisht grupeve të marginalizuara, përmes aktiviteteve informuese. Nga aktivitetet dhe studimi në terren në kuadër të projektit, na rezultoi se komuniteti rom dhe egjiptian, si grupe të marginalizuara, kanë nivel shumë të ulët njohjeje dhe angazhimi me institucionet e pavarura shtetërore dhe institucione të pushtetit lokal.

Pikë fillimi i pengesës për të aksesuar sistemin e drejtësisë është mungesa e informacionit rreth institucioneve përgjegjëse, rruga administrative, tarifat, dhe mjetet ligjore falas. Prandaj, fuqizimi si rekomandim nga Rromano Kham, propozon zbatimin e një kalendari me aktivitete dhe ditë të hapura me institucionet për të ndërtuar linja komunikimi dhe adresimi të problematikave me natyrë sociale dhe ligjore.

2. Ofrimin konkret të ndihmës ligjore falas me buxhetin e shtetit për zgjidhjen e rasteve akute, dhe që kërkojnë trajtim të specializuar si, çështje divorci, birësimi, dhe aksesimi në strehim kur kërkohet mbrojtja e çështjeve me ndihmën e avokatit përpara gjyqit.

Niveli i ulët arsimor, dhe mungesa e të ardhurave ekonomike, zvogëlon dukshëm shanset e komunitetit rom dhe egjiptian, si grupe të marginalizuara, për të ndjekur çështje komplekse dhe me kosto financiare. Ofrimi i ndihmës juridike falas si institucion i ngritur dhe në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, jo vetëm do të lehtësojë aksesin në drejtësi në planin teorik, por do të fuqizojë grupet e marginalizuara për të ndjekur dhe zgjidhur problemet e tyre në rrafshin praktik.